

Ne veprojmë drejt një bote me
natyrë pozitive

Politika Mjedisore e Grupit TITAN

Qershor 2025

V3.1

Përmbajtja

Qëllimi	3
Fushëveprimi dhe zbatimi	3
Vlerësimi i rreziqeve dhe ndikime mjedisore	3
Menaxhimi mjedisor	3
1. Emetimet në ajër	3
2. Kontrolli i zhurmës	4
3. Menaxhimi i tokës dhe mbrojtja e biodiversitetit lokal	4
4. Ruajtja dhe menaxhimi i burimeve ujore	4
5. Mbrojtja e tokës	4
6. Praktikat e ekonomisë qarkore	4
7. Krijimi i një kulture të përgjegjshme ndaj mjedisit	4
Qeverisja dhe përgjegjësitë mjedisore	5
Angazhimi i palëve të interesit dhe transparencë	5
Administrimi i politikës	6

Qëllimi

Në **Grupin TITAN** jemi të përkushtuar ta bëjmë botën një vend të sigurt, të qëndrueshëm dhe të këndshëm për të jetuar. Ne veprojmë çdo ditë me integritet, empati dhe përgjegjësi mjedisore për të formësuar një të ardhme më të ndritur për të gjithë. Politika jonë mjedisore është e rëndësishme për qëllimin tonë dhe ne i japim përparësi minimizimit të çdo ndikimi negativ në mjedis, dhe angazhohemi me palët tona të interesit për të ndërtuar marrëdhënie afatgjata besimi dhe për të krijuar së bashku një ndikim pozitiv.

Adresimi i kërkesave të legjislacionit global dhe lokal dhe standardeve përkatëse është thelbësor për angazhimet tona, të cilat i plotësojmë me premtime vullnetare dhe iniciativa sektoriale. Grupi TITAN investon në teknologji moderne, praktika inovative dhe objekte, zhvillon njohuritë dhe sistemet e menaxhimit dhe bashkëpunon me palët kryesore të interesit për të arritur përmirësim të vazhdueshëm.

Politika Mjedisore e Grupit TITAN (në tekstin e mëtejshëm "Politika") synon të:

- Të ofrojë kornizën e kujdesit të duhur.
- Të përcaktojë qeverisjen dhe përgjegjësitë.
- Të rrisë ndërgjegjësimin për punonjësit tanë, partnerët e biznesit dhe furnitorët.
- Të ndërtojë besimin me të gjitha palët e interesit përmes transparencës dhe veprimeve bashkëpunuese.

Fushëveprimi dhe zbatimi

Kjo Politikë zbatohet për të gjithë punonjësit e Grupit TITAN në të gjitha operacionet dhe filialet dhe mbulon çdo aktivitet nën kontrollin tonë operativ. Derisa njësitë e biznesit brenda Grupit mund të zbatojnë politikat e tyre individuale mjedisore, të përshtatura me kërkesat legjislative lokale, këto politika duhet t'i përmbahen Politikës së Grupit, e cila duhet të jetë e integruar qartë në sistemet e tyre të menaxhimit mjedisor.

Vlerësimi i rreziqeve dhe ndikime mjedisore

Grupi TITAN po përfshin parimet e vlerësimit të materialitetit të dyfishtë në një proces dinamik që përfshin hartëzimin dhe vlerësimin e ndikimit të operacioneve të Grupit në mjedis dhe në shoqëri, si dhe vlerësimin e ndikimeve financiare të rreziqeve mjedisore në Grup.

Për të identifikuar dhe zbutur në mënyrë efektive ekspozimin e tillë, Grupi menaxhon rreziqet e tij në përputhje me praktikën e vendosura ndërkombëtare, duke përfshirë dimensione kryesore të Menaxhimit të Rrezikut të Ndërmarrjes (ERM) në proceset, sistemet dhe qeverisjen e tij.

Menaxhimi mjedisor

Grupi TITAN është i përkushtuar ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së tij mjedisore, i mbështetur nga një sistem menaxhimi i kujdesit të duhur që rishikon dhe monitoron, në nivelin e lartë të menaxhimit, efektivitetin e programeve dhe veprimeve të tij duke vendosur objektiva të korporatës dhe objektiva mjedisore, dhe synon të zbatojë praktikën më të mira dhe të investojë në zgjidhje inovative. Grupi TITAN përputhet me Kartën e Qëndrueshmërisë së GCCA-së, e cila përcakton rregulla për çështje si mjedisi dhe natyra, si dhe për ekonominë qarkore, duke përfshirë edhe bashkëpunimin.

Grupi TITAN ka miratuar sisteme gjithëpërfshirëse menaxhimi në lidhje me:

- Monitorimin dhe raportimin për ndikimin e përgjithshëm mjedisor në ajër, tokë, ujë dhe zhurmë.
- Punën aktive për parandalimin dhe zbutjen e ndotjes dhe zhurmës dhe optimizimin e përdorimit të lëndëve të para, energjisë dhe ujit.
- Zvogëlimin, dhe kudo që të jetë e mundur, minimizimin e gjenerimit të mbeturinave duke zbatuar ekonominë qarkore.
- Rehabilitimin e gurore dhe rritjen e biodiversitetit në zonat me vlerë të lartë të biodiversitetit.

1. Emetimet në ajër

Grupi TITAN ka ndërmarrë veprime për të zhvilluar dhe zbatuar teknikat më të mira në dispozicion për monitorimin, kontrollin dhe zbutjen efektive të emetimeve të nevojshme për të arritur dhe ruajtur një performancë të fortë

mjedisore, duke përbushur kërkesat rregullatore ekzistuese dhe atyre potenciale, si dhe objektivat tona ambicioze vullnetare, duke e pozicionuar Grupin midis performuesve më të mirë në sektorin e vet.

Grupi ynë është i përkushtuar t'i përmbahet rregulloreve rigoroze për kontrollin dhe zbutjen e emetimeve jo vetëm nga burimet në objekte, por edhe nga burimet e emetimeve përmes masave aktive të mirëmbajtjes. Përveç kësaj, ne bëjmë studime mbi shpërndarjen e emetimeve në ajër për të siguruar cilësinë e ajrit të zonave përreth.

Lidhur me emetimet e CO₂, Grupi TITAN ndjek një politikë të veçantë për ndryshimet klimatike.

2. Kontrolli i zhurmës

Grupi TITAN zbaton një program matjesh periodike për të monitoruar dhe kontrolluar nivelet e zhurmës, me qëllim minimizimin e shqetësimit për komunitetet në afërsi. Veç kësaj, Grupi ka krijuar plane veprimi të duhura që zbatojnë praktikën më të mirë të përshtatshme si mbyllja e hapësirave të hapura, bllokimi i zhurmës dhe izolimi.

3. Menaxhimi i tokës dhe mbrojtja e biodiversitetit lokal

Ne zhvillojmë dhe zbatojmë plane rehabilitimi në të gjitha guroret tona, në përputhje me praktikën më të mirë, duke përbushur nevojat dhe pritjet e palëve lokale të interesit, dhe përpikemi të japim shembull në menaxhimin e tokës.

Ne marrim masat e nevojshme për të mbrojtur dhe, kur është e mundur, për të rritur biodiversitetin. Ne zbatojmë plane specifike për menaxhimin e biodiversitetit në të gjitha guroret tona në zonat me vlerë të lartë të biodiversitetit.

4. Ruajtja dhe menaxhimi i burimeve ujore

Angazhimi i TITAN-it për të ruajtur sasinë dhe për të mbajtur cilësinë e burimeve ujore në të gjitha objektet e tij dhe zonat në afërsi synon të zvogëlojë tërheqjen dhe përdorimin e ujit të freskët dhe të minimizojë ndikimin e tij në rrjedhën e poshtme, me anë të riciklimit dhe duke promovuar praktika të përgjegjshme dhe efikase për përdorimin dhe shkarkimin e ujit. Qasja jonë përfshin zhvillimin e teknologjive për efikasitetin e ujit, riciklimin e ujit dhe trajtimin e ujërave të zeza.

5. Mbrojtja e tokës

TITAN ka zbatuar programe të matjes dhe studime bazë, në përputhje me legjislacionin vendor, për të monitoruar cilësinë e tokës dhe për të minimizuar ndikimin e operacioneve tona. Ne i menaxhojmë dhe i ruajmë siç duhet lëndët e para dhe karburantet, dhe i llogojmë mbeturinat nga deponitë brenda kuadrit të një ekonomie qarkore. Veç kësaj, ne kemi zhvilluar plane të përshtatshme emergjence për të adresuar derdhjet dhe shkarkimet aksidentale duke kufizuar dhe shmangur ndotjen e tokës.

6. Praktikën e ekonomisë qarkore

Grupi TITAN është i përkushtuar ndaj parimeve të ekonomisë qarkore, duke filluar që nga zhvillimi i produkteve të reja, dhe zbaton zgjidhje teknike të avancuara për të minimizuar, ripërdorur, ricikluar ose rikuperuar materialet dhe energjinë, duke ruajtur kështu burimet natyrore, duke zvogëluar emetimet e CO₂ dhe duke menaxhuar mbetjet në mënyrë të përgjegjshme.

Ne përpikemi të zvogëlojmë konsumin e lëndëve të para konvencionale dhe karburanteve fosile, duke ulur prodhimin e mbetjeve nga operacionet tona, duke ripërdorur nënproduktet tona, duke minimizuar deponimin e mbetjeve dhe duke menaxhuar çdo mbetje të mbetur, sipas hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve. Ne synojmë të shfrytëzojmë nënproduktet e industrive të tjera për të rritur përdorimin e lëndëve të para alternative në prodhimin e klinkerit, çimentos dhe betonit. Veç kësaj, ne projektojmë dhe zhvillojmë produkte të reja me karbon të ulët për të përbushur nevojat aktuale dhe të ardhshme për ndërtim të qëndrueshëm.

Bashkëpërpunimi i mbetjeve në furat e çimentos si lëndë djegëse alternative është një opsion i krijuar dhe i rregulluar për menaxhimin e mbetjeve. Bashkëpërpunimi i mbetjeve nga proceset e riciklimit ose mbetjeve të paricikluar në prodhimin e çimentos ofron një zgjidhje më të qëndrueshme krahasuar me kthimin e mbetjeve në energji, djegien ose deponimin e mbetjeve, falë rikuperimit të plotë të energjisë dhe riciklimit të materialeve. Kjo qasje sjell përfitime të shumta për njësitë e biznesit dhe komunitetet lokale që përqafojnë parimet e ekonomisë qarkore.

7. Krijimi i një kulture të përgjegjshme ndaj mjedisit

Ne jemi të përkushtuar ndaj Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Kombeve të Bashkuara dhe Dhjetë Parimeve të Kompaktit Global të Kombeve të Bashkuara, duke njohur të drejtën themelore njerëzore të punonjësve tanë dhe komuniteteve lokale për një mjedis të shëndetshëm.

Grupi TITAN inkurajon në mënyrë aktive një kulturë të qëndrueshmërisë duke promovuar sjellje të përgjegjshme ndaj mjedisit tek të gjithë punonjësit dhe kontraktuesit. Ne punojmë së bashku për të pasur një ndikim pozitiv në shoqëri dhe komunitete lokale, duke u përqendruar në qëndrueshmërinë afatgjatë dhe duke mishëruar vlerat e TITAN-it në operacionet tona të përditshme. Ne ofrojmë mundësi për përmirësimin e aftësive dhe rikualifikimin e të gjithë punonjësve tanë, veçanërisht në fushat thelbësore për zhvillim të qëndrueshëm. Ne gjithashtu ofrojmë trajnime mjedisore për kontraktuesit, duke theksuar angazhimin tonë për të rritur ndërgjegjësimin mjedisor.

Qeverisja dhe përgjegjësitë mjedisore

Komiteti Ekzekutiv i Grupit dhe Zyrtares Kryesore për Qëndrueshmëri dhe Inovacion mbajnë përgjegjësinë e përgjithshme për Politikën dhe rishikimet e performancës, derisa **Bordi i Drejtorëve** kryen mbikëqyrjen. Modeli ynë operativ i drejtuar nga performanca përfshin objektivat ESG në nivel lokal.

Departamenti i Grupit për Performancë në ESG është përgjegjës për koordinimin e mbikëqyrjes dhe konsolidimin e veprimeve të qëndrueshmërisë së Grupit, duke siguruar ofrimin e rezultateve më të mira të mundshme. Për të menaxhuar në mënyrë efektive veprimet e qëndrueshmërisë, ne kemi krijuar një rrjet të përbërë nga ndërlidhës në fushën e ESG nga çdo njësi biznesi për të zhvilluar strategji të qëndrueshmërisë dhe për të koordinuar zbatimin e angazhimeve të qëndrueshmërisë në nivel rajonal në të gjithë Grupin.

Të gjithë punonjësit e Grupit TITAN dhe ata të kompanive të degëve të TITAN-it duhet të kenë dijeni dhe t'i përmbahen zotimeve të kësaj Politike, duke marrë pjesë aktive në zbatimin e tyre dhe duke raportuar çdo shkelje.

Çdo punonjës i TITAN-it, pozita e të cilit përfshin vendimmarrjen materiale për aktivitetet që lidhen me mjedisin, si dhe planifikimin ose ekzekutimin e planeve për menaxhimin e aspekteve mjedisore, duhet:

- Të kenë njohuri për parimet themelore të ligjeve mjedisore në fuqi dhe rregulloret përkatëse në çdo vend, shtet ose komunë.
- Të identifikon aspektet mjedisore dhe problemet e mundshme kur ato paraqiten, ashtu siç adresohen në sistemet për menaxhimin mjedisor dhe monitorimin e pajtueshmërisë sonë ligjore.
- Të jenë personalisht të përkushtuar për të arritur pajtueshmëri të plotë me ligjin ekzistues, duke aspiruar dhe promovuar parimet e vlerave dhe politikës mjedisore të TITAN-it.

TITAN pret që kontraktuesit, furnitorët dhe partnerët e biznesit në zinxhirin të vlerës të kenë dijeni dhe të zbatojnë këtë Politikë, si dhe ligjet dhe standardet përkatëse, kur është e përshtatshme. Të gjithë furnitorët duhet të përpiqen t'i përmbahen kërkesave të TITAN-it për mbrojtjen e mjedisit dhe të bëjnë përpjekje për përmirësim të vazhdueshëm në punën e tyre. Titan-i i kualifikon furnitorët e tij në mënyrë të përshtatshme, sipas performancës së tyre në këtë fushë në përputhje me Politikën e Prokurimit të TITAN-it.

Angazhimi i palëve të interesit dhe transparenca

Ne angazhohemi me palët kryesore të interesit në veprime bashkëpunuese për të ndërtuar besim, për të kuptuar më mirë ndikimin e operacioneve tona, për t'iu përgjigjur shqetësimeve të tyre mjedisore dhe për të zhvilluar zgjidhje të zbatueshme, si dhe ndajmë njohuritë dhe praktikën më të mira. Palët tona kryesore të interesit përfshijnë punonjësit, komunitetet lokale, partnerët e biznesit dhe furnitorët, klientët, OJQ-të, akademinë dhe rregullatorët.

Në këtë drejtim, Grupi TITAN investon burime në iniciativë të përbashkëta bashkëpunuese globale dhe lokale për të rritur përpjekjet tona të qëndrueshmërisë. TITAN kontribuon në zhvillimin e udhëzimeve specifike për sektorin, si dhe metodave dhe standardeve shkencore, duke mundësuar kështu një qasje globale sektoriale për arritjen e menaxhimit të mjedisit.

Ne bëjmë studime të ndikimit mjedisor kur zgjedhim vende të reja ndërtimi ose para se të bëjmë ndryshime të mëdha në vendpunishtet ekzistuese, në përputhje me kërkesat legjislative lokale, standardet sektoriale dhe praktikën më të mira, duke marrë parasysh reagimet nga procesi i konsultimit publik.

Ne parashikojmë dhe adresojmë në mënyrë proaktive nevojat e klientëve tanë duke ofruar materiale dhe zgjidhje inovative, të qëndrueshme dhe me kosto efektive. Qëllimi ynë është të minimizojmë ndikimin në mjedis që lidhet me ndërtesat dhe infrastrukturën në të gjithë zinxhirin e vlerës së ndërtimit. Ne publikojmë Deklaratën Mjedisore të Produkteve për produktet tona të verifikuara nga palët e treta, duke u ofruar klientëve informacionin e nevojshëm.

Si kompani publike, TITAN S.A. është në përputhje me obligimet rigoroze të qeverisjes dhe raportimit të Kodit Belg të Qeverisjes Korporative, Direktivës së Raportimit të Qëndrueshmërisë Korporative (BE) dhe Rregullores së Taksonomisë (BE). Raportet dhe deklaratat e performancës ESG të Grupit validohen çdo vit nga verifikues të pavarur.

Administrimi i politikës

Departamenti i Performancës ESG i Grupit është përgjegjës për administrimin dhe përditësimin periodik të kësaj Politike. Çdo rishikim që paraqitet nga Departamenti i Performancës ESG i Grupit kërkon miratimin nga Komiteti Ekzekutiv i Grupit.